



SENATI

Rr. "Vangjel Noti" Nr 25, Laprakë, Tiranë, Tel. 04 2 454 893: 067 40 63 042, Web: www.kub.edu.al; Email: info@kub.edu.al

Nr. 123/4 Prot.

Tiranë, më 2/05/2020

RREGULLORE

Nr. 13

**PER PARANDALIMIN E PANDEMISE NE VEPRIMTARINE
AKADEMIKE NE KOLEGJIN UNIVERISTAR "I BIZNESIT**

Neni 1

Baza ligjore

Akti Normativ i Këshillit të Ministrave Nr. 3 datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19", i ndryshuar; VKM nr. 243 dt. 24.03.2020 "Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore"; Statutin e Kolegjit Universitar "I Biznesit", Rregullorja "Për procedurën e mësimdhënies online, në KUB në kushte situatë të jashtëzakonshme dhe fatkeqësie natyrore të epidemisë"; Urdhrit nr.104 dt.30.04.2020, të MASR "Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik për shkak të gjëndjes së fatkeqësisë natyrore të COVID-19", urdherin nr 289 date 04.05.2020 " për miratimin e udhezuesit për " Masat ndaj Covid 19 qe duhet te marrin institucionet e arsimore",

Neni 2

Objekti i rregullores

Veprimtaria akademike dhe administrative ne te gjithë strukturat e KUB, per kohen e pandemise.

Neni 3

Qellimi

Disiplinimi i te gjithë procesit te arsimimit dhe veprimtarise akademike e administrative ne mjediset e KUB, Godina A dhe Godina B, ne kushtet e kerkesave profilaktike dhe kondicionit fizik e social te mjediseve, personelit dhe studenteve sipas udhezimeve te percaktuara ne urdherin nr 289 date 04.05.2020 te MSHMS.



Neni 4

Autoritetet dhe pergjigjesite

Autoritetet pergjegjese ekzekutive, jane te gjithë drejtuesit kryesor, drejtuesit e njesive kryesore dhe baze, drejtuesit e pergjegjesit e çdo zyre e sektori, ne sferen e veprimtarise e te pergjegjesise funksionale, per te kerkuar respektimin e kerkesave te protokollit te udhezimit te MSHMS, protokollit perkates dhe kerkesave te kesaj rregullorje, ashtu sikunder kane autoritetin e propozimit e te marrjes masave per shkeljet e konstatuara.

Neni 5

Detyrueshmeria e cdo personi

Cdo person, qofte ky drejtues apo student, punonjes apo vizitor, do te respektoje kerkesat e protokollit te hyrjes, ne mjediset e jashtme e te brendshme, ne zyra apo salla leksioneshe e seminaresh, laboratore apo mjedise te tjera publike, rregullin baze te vetedizinfektimit dhe vetemaskimit, (mbajtjes se maskes), distanciomit social dhe te ushtrimit te kerkeses ndaj cilitdo per te respektuar masat e ruajtjes nga covid19 sic jane publikuar. Ne rast te kunder eshte i vetperjashtuar nga veprimtaria, apo kerkesa e tij.

Neni 6

Frekuentimi dhe masat e hyrjes ne institucion

Personeli akademik e jo akademik, studentet dhe vizitoret, duhet te respektojne levizjen per ne mjedisin perkates duke ruajtur distancen me kurrizin e shokut 1 m larg dhe perballe jo me pak se 2 m. Ne mjedisin e jashtem publik, mund te qendrojne lirshem ne grup duke ruajtur distancen prej 1 m ne nje zone rethore me reze 1 m. Levizjet hyrese do te jene vetem ne radhe ku sejcili do te dizinfektoje duart para se te hyje ne mjedisin e punes apo mjedisin e mbyllur.

Neni 7

Disiplina profilatike e vendit te punes

Stafi akademik dhe jo akademik, sekretarite dhe punonjesit administrativ para se te hyjne ne zyre, te freskojne mjedisin dhe te dizinfektojne duart. te mbajne masken ne fytyre kur jane me te tjeret ne te njeten zyre, te ruajne kondicionin fizik dhe te mos lejojne ne zyrat e tyre te futen persona te tjere pa maske dhe te pa autorizuar. Pas largimit nga zyra te bejen disenfektimin e plote te saj duke pastruar me kujdes siperfaqet e rrafshata dhe dorezat e derve.



Neni 8

Frekuentimi i mjedieve mesimore

Studentet do te frekuentojne oren e mesimit/seminarit/provimit/laboratorike duke ruajtur kerkesat e nenit 7, ne salla te cilat sigurojne kurbaturen e nevojshme dhe kondicionin social te distancimit. Per kete arsye sipas numrit te grup seminareve apo leksioneve te programohet koha e frekuentimit te sallave. Studentet respektojne vetem kohen, sallen dhe vendin e programuar per ta dhe asnje kohe ehapsire tjeter. Kjo nuk tolerohet.

Neni 9

Madhesia e grupit per frekuentimin e salles ne njesine e kohes

Grupet mesimore ne sallat seminarike do te jene jo me shume se 15 vete dhe ne sallat e leksioneve jo me shume se 20 vete, ne provim sipas kapacitetit te salles duke ruajtur permasat e percaktuara te sigurise. Koha e qendrimit ne salle nuk mund te jete me shume se 2 ore mesimore.

Neni 10

Roli i Pedagogut

Pedagogu, eshte ne te njeten kohe sa mesimdhenes dhe vezhgues i gjendjes shendetesore te auditorit. Me rastin me te pare te konstatimit te ndryshimit pamjes fizike, apo kollitje te panderprera e shenja te tjera dalluese te infektimit te ndonje studenti, nderpret oren e mesimit dhe njofton menjehere adminisistratorin dhe sanitaren per marrjen e masave perkatese dizinfektuese, pavaresisht nga prania ose jo e rrezikut. Sipas rastit njoftohet 127 ose 08000888

Neni 11

Publikimi i protokollit dhe kontrolli i mjedisit

Ne KUB, ne te dy mjediset, Godina A dhe Godina B, caktohet nje ekip pergjegjes per ndjekjen, publikimin e masave kunder covid19 dhe kontrollin e respektimit te masave higjeno sanitare, ekip i behet i njohur nga gjithë personeli akademik, administrativ e studentor. Ai ka autoritetin e pergjegjesine e realizimit te monitorimit, kontrollit te disiplines dhe ruajtjes se kondicionit higjeno sanitar ne KUB. Ai percaktohet me urdher te Administratorit ne KUB dhe behet i njohur per te gjithë.



Neni 12.

Mjetet, pajisjet dhe procedura e perdorimit

Ne nje kend te dukshem ne te dy godinat vendosen pajisjet perkatese profilaktike, emrat e ekipit per monitorimin dhe kontrollin e disiplines pandemike, orari i profilaksise dhe kujtesa per cdo person per respektimin e masave perkatese kunder pandemise te ekipit te eksperteve ne RSH..

Neni 13

Frekuentimi i mjediseve publike, kafe bar

Frekuentimi i kafobar eshte i lejuar vecanerisht per te marre kafe dhe per ta konsumuar ne mjedis te hapur. Brenda ne lokalin e Kafes, lejohet pirja e kafes vetem ne kushtet e distancimit te tavolinave sipas kondicionit dhe protokllit perkates. Ne mjediset jashte lejohet jo me shume se dy vete ne tavoline.

Neni 14

Efektet e kesaj rregullorje

Kjo rregullore shtrin efektin e vet mbi te gjitha ata qe jane ose jo personel, jane ose jo student, por qe ne nje moment ndodhen qofte edhe rastesisht ne mjediset e Kolegit Universitar te Biznesit dhe shtrin efektin e saj per aq kohe sa eshte e percaktuar ne aktet ligjore e nenligjore per kete sitate dhe sitata te ngjashme. Per cdo rast mos bindje, nga personeli jo efektiv, kerkohet ndihma e 112, ose 129 per mbeshtetje

Neni 15

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore Hyn ne fuqi menjehere.

Krytari Senatit

Prof. Dr. Leandro Haxhi

